

VASKË MILKANI

VËZHGIME MBI EMËRTIMET E NJERËZVE SIPAS
PROFESIONIT

Problemet që lidhen me emërtimet e njerëzve sipas profesionit¹, si çështje të leksikut dhe të fjalëformimit, gjër më sot nuk janë bërë objekt i veçantë studimi në punimet tona gjuhësore. Fjalorët e ndryshëm dygjuhësh, të botuar para dhe pas çlirimit, i kanë pasqyruar emërtimet e njerëzve sipas profesionit në përputhje me kohën, karakterin dhe qëllimin për të cilin janë hartuar. Rrjedhimisht, studimi i këtij problemi është i rëndësishëm si nga ana gjuhësore ashtu edhe nga ana shoqërore, sepse emërtimet e njerëzve sipas profesionit flasin për ndryshime në jetën shoqërore dhe janë të lidhura ngushtë me veprimtarinë prodhuese. Te këto emërtime kryqëzohen aspekte të ndryshme të prodhimit, që pasqyrojnë ndryshimet në ndarjen e punës, në proceset teknologjike të prodhimit, në specializimin e procesit, në mjetet, në sendet, në produktet e punës, në ndryshimin e pronësisë etj. Në këtë punim ne do të trajtojmë shkurtimisht gjendjen e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit para dhe pas çlirimit, pasqyrimin e tyre në fjalorët kryesorë të fundit të shek. XIX e të fillimit të shek. XX, veçanërisht në «Fjalorin e gjuhës shqipe» të vitit 1954. Do të flasim gjithashtu edhe mbi ndikimin e ndryshimeve shoqërore të pasçlirimit në fushën e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit dhe prirjet e sotme të zhvillimit në fushën e fjalëformimit.

Emërtimet e njerëzve sipas profesionit, në periudhën e paraçlirimit, ishin të përhapura dhe zinin një vend të mirë në fondin themelor të leksikut. Fjalori i gjuhës shqipe² i hartuar nga Kristoforidhi në vitet 70-80 të shek. XIX, që pasqyron në mënyrë shkencore pasurinë leksikore të shqipes, ka gati njëqind emërtime të tilla. Zhvillimi i tregëtisë dhe i zanateve të ushtruara në Shqipëri në shek. XIX dhe në fillim të shek. XX³ flasin për përdorimin e mjaft emërtimeve të njerëzve sipas profesionit, të cilat, në ndonjë rast si: *belaxhi, hamallicë, teneqexhi, bojaxhi, dyqanxhi, kafexhi, vegjetore, kosaxhi, shataxhi, lase*

1) Me fjalën *profesion* do të kuptojmë të ushtruarit e një aktiviteti me karakter mendor ose artistik, të një pune të njeriut në jetë, të një funksioni, të një zanati, që kërkon edhe njohje të thelluar në një fushë të caktuar të veprimtarisë.

2) K. Kristoforidhi, *Fjalor shqip-greqisht*, 1961.

3) Rr. Zojzi, *Tregu i Shkodrës dhe fillimet e industrisë së mëndafshit në vendin tonë*, «Bul. Shk. Shoq.» 1954, nr. 1, f. 115; K. Misha, *Mbi fillimet e lëvizjes punëtore në Shqipëri*, «Bul. Shk. Shoq.», 1955, nr. 1, f. 36; Z. Shkodra, *Zhvillimi i tregëtisë në Shqipëri në shek. XIX-të*, «Bul. Shk. Shoq.», 1955, nr. 1, f. 57; *Prodhimi i mallrave në Shqipëri në shek. XIX-të*, «Bul. Shk. Shoq.», 1955, nr. 4, f. 125.

etj., edhe pse kanë patur përhapje dhe përdorim, nuk kanë gjetur pasqyrim në Fjalorin e Kristoforidhit. Ky fenomen, mendojmë, se ka të bëjë ose me mbledhjen jo të plotë të tyre prej autorit (për fjalët shqipe), ose me qëndrimin e ndërgjegjshëm të tij për të lënë jashtë turqizma, që shënonin njerëz sipas profesionit.

Shumica e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në këtë periudhë, që gjenden në fjalorin e Kristoforidhit, si: *gjobar, kamatar, kandiler, kokmexhi, kutrovaxhi, shegert, terezi* etj. kanë të bëjnë me fushën e zejtarisë, të tregëtisë, të shërbimit komunal dhe janë pasqyrë e marrëdhënjeve feudale, e nivelit të ulët të forcave prodhuese, që sundonin në Shqipëri.

Fjalori i Kordinjanos dhe ai i S. Manit⁴, në krahasim me atë të Kristoforidhit, kanë një numër më të madh emërtimeve të njerëzve sipas profesionit. Por kjo nuk do të thotë se këtu ato u pasqyruan plotësisht. Nuk gjenden emërtime që dokumentohen në atë kohë, si: *piktor, korrektues, centralist, distilar, korier karpientier, arkivist, kopist, gazetashitës* etj. Një vend të madh në këta fjalorë zënë variantet fonetiko-dialektore, si: *qertar, qeretar; mandeshë, mendeshë; gjëzar, gjëzar; gjikatës, gjykatës; bukëpjekës, bukëpjekës* etj.

Nga ana tjetër, shumë emërtime të gjetura në këta fjalorë, si: *automobilngarës, deftermbajtës, leverelarës, gazetatar* etj., mendojmë se janë krijime ose kalkime nga gjuhët e huaja dhe, si rrjedhim, nuk kanë gjetur as përdorim.

Interes të veçantë paraqet vështrimi i emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në «Fjalorin e gjuhës shqipe»⁵ të vitit 1954, që shënoi një etapë të re në fushën e hartimit të fjalorëve shpjegues të shqipes. Përparimet e mëdha politike, ekonomike dhe shoqërore nuk mund të mos sillnin ndryshime të rëndësishme në kategorinë e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit. Lindën shumë emërtime të reja, u rrëgjua numri i emërtimeve të huaja e të vjetra; ndryshime të ndjeshme u bënë në kuptimet e veçoritë stilistike të emërtimeve; u rrafshuan shumë dallime dialektore. Këto gjëra, në një masë të ndjeshme, për herë të parë u dhënë në «Fjalorin e gjuhës shqipe».

Por, duhet vënë re, se në «Fjalor...» nuk gjen emërtime të tilla, si: *armator, baltpunues, cigareshitës, duhanpunues, hekurpunues, gurgdhëndës, lëkurëpunues, nallanepunues, jorganpunues, këpucëbërës, qymyrpunues, kryegjeolog, pompist, eskavatorist, hekurkthyes, kryeinzhinier, kryemekanik, kryemjek, letërshpërndarës* etj.⁶, megjithëse vetë koha, rendi i ri shoqëror tregonte prirjen e zhvillimit të tyre⁷.

Vend i madh në «Fjalor...» u është dhënë varianteve fonetiko-dialektore (*kujunxhi, kujxhi; senksër, sekser; ngjizar, gjizar; dhenar, dhënar; shkrirës, çkrirës; delmer, dylmer; druvar, druvar; mëndeshë, ma-*

4) F. Cordignano, *Dizionario Albanese-Italiano*, Milano 1934; S. Mann, *An historical Albanian-English Dictionary*, London 1948.

5) Instituti i Shkencave, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1954.

6) Shih «Gazetat zyrtare» të viteve 1947-1948 dhe A. Kostallari, *Në rrugën e hartimit të Fjalorit normativ të shqipes së sotme*, «Bul. Shk. Shoq.», 1955, nr. 4, f. 22.

7) Shih për këtë edhe «Gazetat zyrtare», 26 qershor 1947, f. 2 dhe 22 maj 1948, f. 1, ku, midis të tjerash, thuhet: «Profesionet e poshtëshënuara... klasifikohen sipas rëndësisë dhe perspektivës së zhvillimit të tyre». «Ky grup ndahet në katër kategori sipas rëndësisë së profesioneve, sipas zgjerimit që duhet të marrin profesionet që janë faktorë për ngritjen e ekonomisë dhe industrializimin e vendit».

ndeshë; llustraxhi, lustraxhi) dhe sinonimeve fjalëformuese (*fallxhi, fallguer, fallçor, barkaxhi, barkator; bandaxhi, bandëtar; murg, murgar* etj.).

Pa lënë mënjanë funksionin informues të «Fjalorit të gjuhës shqipe», duke bërë shtresëzimin e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit, ishte e udhës që për emërtimet e vjetëruara dhe për fjalët me origjinë turke të kihej parasysh vlera e tyre stilistike.

Shpjegimi i emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në «Fjalor...» disa herë nuk është i plotë dhe i saktë. Fjala *mësues* shpjegohet: «ai që e ka për profesion të japë mësim⁸»; *pedagog*: «ai që edukon fëmijët sipas parimeve të pedagogjisë»; *akrobat*: «ai që ka zanat të bëjë lojra të rrezikshme, duke ecur lart mbi tërkuzë dhe duke përdorur çfardo veglash: pehlivan»⁹; *flautist*: «ai që i bije fyellit»¹⁰; *motorist*: «mekaniku që drejton një makinë» etj.

Për pasqyrimin e paplotë të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në «Fjalor...» flet edhe mungesa, pothuaj tërësore, e emërtimeve të grave sipas profesionit¹¹, në një kohë kur gruaja kishte filluar të ushtronte aktivitet në të gjitha sferat e jetës politike, ekonomike dhe shoqërore, kur në gjuhë është e fuqishme prirja për të emërtuar profesionet e grave me fjalë të veçanta, kur emërtimet përkatëse të burrave në «Fjalor...» ekzistojnë. Mungojnë p.sh.: *arkëtare, akrobate, bibliotekare, centraliste, kontrollore, mjeke, mekanike, operatore, patologe, redaktore, regjizore* etj.

Në periudhën e pasçlirimit numri i emërtimeve të njerëzve sipas profesionit u rrit në mënyrë të dukshme, duke pasqyruar ndryshimet e thella në jetën e vendit, rritjen e industrisë, të transportit, të shkencës, të tregëtisë, mekanizimit e bujqësisë, përsosjen e formave shoqërore të shërbimit të popullsisë etj. Kështu brenda 25 vjetve të fundit janë përhapur rreth 5000 profesione e detyra të reja në proceset më të imta të punës. Në qoftë se në vitin 1947 ligji i kategorizimit të punëtorëve përfshinte vetëm 85 profesione kryesore, prej të cilave vetëm 50 lidheshin me përdorimin e maqinave, në vitin 1962 librat e kategorizimit përfshinin mbi 1100 profesione kryesore, prej të cilave mbi 800 kanë të bëjnë me përdorimin e maqinave. Nga ana tjetër, u zgjeruan ato profesione të punës fizike që kërkojnë jo aq forcë krahu se sa punë mendore, jo aq përvojë thjesht empirike se sa dije shkencore teknike. Në këto lloje profesionesh një vend të gjerë zënë procese të tilla të punës mendore, si kontrolli dhe vrojtimi aktiv i aparaturave, i maqinave dhe i proceseve teknologjike, grumbullimi dhe përpunimi i informacionit, korigjimi i maqinave etj. Emërtime të tilla, si: *petëzues, armator, kohëshënues, elektrovincier, elektrofiltrues, elektroteknik, saldues, drejtues, montues,*

8) Shih «Zëri i Popullit» 6 dhjetor 1968, f. 3: «Mësuesi nuk është thjesht mësimdhënës, por edukator, njeri politik...».

9) Ky shpjegim nuk është i plotë, sepse mund të jesh akrobat dhe të mos ecësh mbi tërkuzë dhe për më tepër akrobati «nuk ka zanat të bëjë lojra të rrezikshme», por të tregojë nivelin e përgatitjes fizike, shkathtësinë, guximin dhe trimërinë.

10) Është e qartë se flautisti është ai që i bije flautës ose ai që lot në flautë.

11) Në «Fjalor...» mungojnë edhe emërtime të tilla, që kanë qenë ushtruar prej femrës, qysh në shekullin e kaluar. Shih për këtë Rr. Zojzi, *Tregu i Shkodrës dhe fillimet...*, f. 119; *Hjektore*, thirret ajo grue që heq mëndafsh; *Vegjetore*, thirret ajo grue që me vegje punon vetëm pëlhurë; K. Misha, *Mbi fillimet e lëvizjes punëtorë...*, f. 36: «Në Shkodër një numër i madh *hamallicash*.. mbushnin rrugët e pazarit». «Një *vegjetore* e mirë që punonte 16 orë nuk fitonte më shumë se 6 grosh ditën».

nikelues, shkrirës, kromues, pregatitëse (e fletkatodave në elektrodën e bakrit) etj., ndeshen në ndërmarrjet tona industriale me një shkallë të lartë mekanizimi ose automatizimi, si p.sh. në metalurgji, në fabrikat e plehrave kimike, në centralet elektrike etj. Nga ana tjetër, është rritur inteligjenca dhe rrjedhimisht është shtuar edhe numri i emërtimeve të tilla, si: *redaktor, mjekë, projektues, gjeofizik, grimior, skenarist, muzikolog, pianist, operator* (filmi), *baletmaestër, korrektor, skulptor, drejtor, kryetar, inxhinierë, piktur, karikaturist, ekonomist* etj. që flasin qartë për një punë mendore të kualifikuar dhe shumë të kualifikuar krijuese ose jokrijuese.¹²

Rritje të konsiderueshme patën edhe emërtimet e grave sipas profesionit: *shkrirëse, tekstiliste, minatore, kryeinxhinierë, pllakashtruese, filaturiste, traktoriste, hekurkthyesë, pompiste, tornitore, operatore, mjelëse, stalliere, montatore, motoriste* etj., gjë që shpjegohet me pjesëmarrjen e saj të gjerë në prodhimin shoqëror, me barazinë e saj me burrin, me qëndrimin e ri shoqëror dhe me luftën për emancipimin e plotë të saj.¹³

Treguesi sasior i procesit të zgjerimit të kategorisë së emërtimeve të njerëzve sipas profesionit, paraqet padyshim interes të padiskutueshëm, por, megjithatë, duhet të theksojmë se rëndësi të veçantë ka ana cilësore e këtij procesi. Prej kësaj kategorie u rrëgjuan, para së gjithash, emërtimet që janë karakteristike për shoqërinë feudale e borgjeze, dhe të huaja për shoqërinë socialiste, të cilat i zhdukuri revolucioni ose u zhdukën gradualisht në kushtet e reja shoqërore. Një pjesë e mirë e këtyre emërtimeve, si trashëgim i periudhës së paraçlirimit, përdoren edhe në kohën tonë, kur flasim për ngjarje të së kaluarës, si: *tregëtar, fajdexhi, gjobtar, qatip, ordinancë, kamatar, bakall, dhjetar, sekser, taksidar, tagrambledhës, sejmen, gardian* etj.

Këtu mund të numërojmë edhe emërtimet e dikurshme të zanateve të shtresave të ulta të shoqërisë, si: *hamallicë, hyzmeqar, keçan, hallajkë, kopile, gjysmatar, argat* etj. Disa emërtime u kufizuan në përdorim, por mbetën të fiksuara në shprehje të qëndrueshme, në proverba megjithëse më parë ishin emra të përgjithshëm. Kështu gjejmë emërtime të tilla në togun: «e bëj *çirak*» e ndonjë tjetër. Disa emërtime të njerëzve sipas profesionit, që kanë kaluar në sferën e arkaizmave dhe në shtresat leksikore stilistikisht pejorative, sot i gjejmë të ngulitura si mbiemra (llagape) njerëzish. Të tilla janë: *kazaz, saraq, heqim, pehlivan, qeramixhi, xherah, terezi, kundraxhi, kallfë, tabak, avxhi, kujunxhi, bakall, çezmaxhi; qahja, kazanxhi, çirak* etj.

Ndryshimi i emërtimeve të njerëzve sipas profesionit kalon jo vetëm në rrugën e shfaqjes së fjalëve të reja dhe të rrëgjimit të fjalëve të vjetra, por edhe në rrugën e ndryshimit kuptimor, dmth. në rrugën e lindjes në fjalë të kuptimit të ri. Kjo gjë vihet re te ato emërtime të njerëzve sipas profesionit, kur emërtimi ruhet, por ka ndryshuar roli, sfera, përdorimi i tij. Kështu ndodhi me emërtime të tilla, si: *punëtor, mësues, shërbëtor, kasap, bakall, matrapaz* etj.

12) Shih edhe A. Uçi, *Revolucioni tekniko-shkencor dhe ngushtimi i dallimeve esenciale midis punës fizike dhe punës mendore*. «Zëri i Popullit», 6 dhjetor 1969, f. 2.

13) Më gjerë shih për këtë edhe K. Sima, *Vëzhgime mbi emërtimet e reja të grave sipas profesionit në fushën e prodhimit industrial pas çlirimit*, «St. filologjike» 1, 1970. f. 85.

Sot fjala *punëtor* tregon, në radhë të parë, pjesëtarin e klasës në fuqi, veç kësaj ajo pësoi dhe zgjerim kuptimi në përdorime të tilla si: *punëtor partie, punëtor i ekonomisë, punëtor operativ, punëtor politik* etj.

Nga ana tjetër, me specializimin e prodhimit, me fjalën *punëtor* krijohet një varg i panumërt përdorimesh, si: *punëtor maqinash, punëtor hekurudhash, punëtor i gërmimit të dheut, punëtor shkarkues* etj.

E njëjta gjë ndodhi edhe me fjalën *mësues* në përdorime të tilla, si: «*mësues i madh dhe i pagabueshëm është vetë populli*»; «*mësuesi ynë i dashur shoku Enver*» etj., ose me fjalën *shërbëtor* në përdorime të tilla, si: «*shërbëtor i popullit*», *shërbëtorë të imperializmit dhe revizionizmit* etj. Si rezultat i ndryshimeve shoqërore dhe i specializimit të prodhimit, ndryshime kanë ndodhur edhe te fjala *kasap*. Sot me të nuk kuptojmë atë që shet dhe shet mish, sepse kasapët, ose si quhen sot punëtorët e thërtores, kanë specialitete të ndryshme duke u emërtuar sipas procesit të punës, (*therës, rjepës, manipulues* i zorrëve, dhjamt, *pastrues* etj.), kurse ai që shet mish quhet *mishtar, mishshitës*, ose thjesht *shitës*.

Disa emërtime, pas fitores së revolucionit popullor, jo vetëm që u pasuruan me kuptime të reja, por fituan edhe ngjyrimë emocionale. Disa prej tyre fituan një nuancë të keqe, përbuzëse; të tjera, përkundrazi, fituan ngarkesë pozitive. Në të vërtetë, këtu kemi të bëjmë me pasqyrimin në gjuhë të qëndrimit të ri shoqëror ndaj punës dhe njerëzve të saj, duke e quajtur të nderuar çdo punë dhe duke përbuzur çdo gjë të prapambetur dhe feudale. Mund të radhisim një sërë emërtime, që fituan ngarkesë pozitive, si: *punëtor, shërbyes, çoban, fshatar* etj. Fituan ngarkesë negative, përbuzëse emërtime të tilla, si: *fajdexhi, taksidar, sejmen, qahja, dhjetar, tagrambledhës, fallxhore* etj. Ky qëndrim i ri ndaj punës, po shfaqet me një prirje të mirë zhvillim edhe përsa i përket zëvendësimit të prapashtesave turke me prapashtesa shqipe, ose me mbiemra foljorë të substantivuar.

Këtë që po ngjet sot në gjuhën shqipe mund ta quajmë rivlerësim të emrave të njerëzve sipas profesionit, rivlerësim që sjell me vete lindjen e një ndjenje të re gjuhësore në përshtatje me ndryshimet e thella politike, ekonomike e shoqërore, me qëndrimin e ri shoqëror ndaj punës dhe njeriut të saj. — në një vështrim më të gjerë — me detyrat e punonjësit ndaj shoqërisë.

Ndryshimet në kategorinë e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit, që u përmëndën më lart (zgjerimi sasijor, lëvizja cilësore, ndryshimet në anën kuptimore) në mënyrë të drejtpërdrejtë kushtëzohen nga faktorët jashtëgjuhësorë. Por në kategorinë e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit kanë ndodhur edhe ndryshime të kushtëzuara nga bashkëveprimi i faktorëve gjuhësorë me ata jashtëgjuhësorë. Në këto raste ndodh ndarja, grupimi i emërtimeve në bazë të tipeve të motivuara sipas procesit të punës, sepse çdo emërtim, përgjithësisht, i përmbahet një procesi pune të veçantë dhe pothuaj gjithmonë të lidhur me produktin, mjetin e sendin e punës. Duke pasur parasysh këtë anë, emërtimet e njerëzve sipas profesionit në përgjithësi mund t'i ndajmë në këto tipe kryesore kuptimore:

I. Tipi i emërtimeve sipas procesit të punës, i krijuar kryesisht në periudhën e pasçlirimit, ka një përhapje të gjerë: *montues, nikelues, drejtues, transportues, shikues* (i prodhimit), *endëse, mjelëse, peshues, fryrës* (i xhamit), *asfaltues, shkrirës, kromues, mbërthyes* (i kazaneve të avullit),

pregatitës, mbulues, pregatitëse (e fletkatodave në elektrodën e bakrit)¹⁴ etj.

II. Tipi sipas mjetit të punës, i përhapur edhe para çlirimit, ka zhvillim të mirë edhe në vitet e pasçlirimit: *barkatar, karrocjer, belaxhi, shataxhi, qerrtar, ruliste, tornitore, vagonist, eskavatorist, frezator, shaptilografiste, zetorist, vinçiere, linotipist* etj.

III. Emërtimet sipas produktit të punës kanë pasur përdorim të gjerë në periudhën e paraçlirimit: *gjizar, djathtar, tërkuzar, opingar, vorbaxhi, qerumixhi, salepçi, bozaxhi, jorganxhi, samarxhi, qeleshexhi, kosaxhi* (ai që bën e shet kos), *tullaxhi, tjegullar, këpucar, poçar, shportar, bukator, bukatore, shoshar* (ai që punon shosha) *gjellëtor, shportar* etj.

IV. Emërtimet sipas lëndës ose objektit të punës, të përhapura në periudhën e paraçlirimit, kanë një sferë më të kufizuar përdorimi sot: *argjendar, armëtar, sheqerxhi, hekurxhi, kallajxhi, mëndafshar, llamarinist, bojaxhi, bitumist, narkotizatore* etj.

V. Tipi i emërtimeve sipas vendit të punës ka qenë i përhapur edhe në periudhën e paraçlirimit: *furrtar* apo *furraxhi, hanxhi, dyqanxhi, hotelxhi, bahçevan, qilarxhi, lulishtar, postjer, vreshtar, vreshtare, banakier, kuzhinier, bibliotekar, portjer, farmacist, kopshtar, stanar, laborant*.

VI. Tipi i emërtimeve sipas degës së ekonomisë i përket kryesisht viteve të pasçlirimit: *metalurg, biegtor, tekstilist, tekstiliste, filaturiste, minator, minatore* etj.

Vëzhgimet tona për periudhën e pasçlirimit dëshmojnë se në kategorinë aktive të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit vazhdon të jetë në rritje grupi i emërtimeve sipas procesit të punës (këtu duhet të shtojmë edhe emërtimet e shprehura me kompozitë) e sipas mjetit të punës dhe në rënje tipi sipas produktit të punës. Kjo rritje do të shkojë më tej, sepse në të pasqyrohet qartë procesi i mëtejshëm i ndarjes së punës, i mekanizimit të procesit, i shfaqjes së maqinave dhe aparateve të reja.

Me interes është të vështrohen këto grupe edhe nga pikëpamja e abstraksionit semantiko-fjalëformues. Te grupet e ndryshme shkalla e këtij abstraksioni nuk është e njëjtë.

Grupi I (*montues* etj.), II (*qerrëtar* etj.), III (*opingar* etj.) kanë një shkallë më të lartë dhe pothuaj të përgjithësuar të abstraksionit semantiko-fjalëformues, kurse grupi IV (*argjendar, armëtar* etj.) dhe V (*furrtar, kopshtar* etj.) janë në një shkallë më të ulët abstraksioni. Kjo gjë pasqyrohet në zbërthimin kuptimor të rasteve një për një. Ndërsa nga njëra anë kemi: *montues* = ai që monton., pra *ai që + foljen përkatëse* për të gjithë grupin I, *qerrëtar* = ai që punon me qerre, pra *ai që punon me ose në + veqlën përkatëse* për të gjithë grupin II, *opingar* = ai që bën opinga, pra *ai që bën + sendin përkatës* për të gjithë grupin III, *metalurg* = ai që punon në metalurgji, pra *ai që punon + degën e prodhimit* për të gjithë grupin IV. Nga ana tjetër, kemi: *argjendar*: ai që punon me argjend, që nxjerr sende argjendi, *mishtar* = ai që shet mish, *armëtar* = ai që bën armë e me radhë për gjithë grupin IV; ose për ti-

14) Problem për emërtimet e njerëzve sipas profesionit përbën çështja e dallimit të emërtimeve me vlerë leksikore, nga ato të rastit, të përdorura në librat e kategorizimit sipas punës që bën dikush. Mendojmë se këtij problemi nuk është e mundur sot për sot t'i jepet zgjidhje e prerë, sepse procesi i emërimit të njerëzve sipas profesionit është në një fazë dinamike të zhvillimit të tij. Në këtë punim ne nuk kemi parasysh këtë problem dhe shpesh do të mbështetemi edhe në literaturën shtetërore apo zyrtare mbi emërtimet e njerëzve sipas profesionit.

pin V *vreshtar* = ai që punon vreshtë, *kopështar* = ai që merret me kopshtari, ai që punon në kopsht, *furrtar* = ai që pjek bukë etj.

Kjo analizë ka rëndësi praktike në dy anë: së pari, tri grupet e para, që për nga abstraksioni semantiko-fjalëformues afrohen shumë me abstraksionin gramatikor, ndryshe nga dy grupet e tjera, që janë tipike për abstraksionin fjalëformues, formojnë një tip më vete me një mënyrë unike shtjellimi, gjë që ka rëndësi në praktikën leksikografike, në shpjegimin e fjalëve të kësaj natyre me ndihmën e formulave të përpunuara e të përgjithësuara. Së dyti, në sistemin e mjeteve e të mënyrave të fjalëformimit kjo analizë duhet lidhur me strukturën e kompozitave përgjegjëse, jo vetëm të atyre që ekzistojnë realisht por edhe të atyre që mund të formohen, që kanë prirje të lindin. Kështu p.sh. grupi III përgjithësisht në shqipe ka edhe kompozita përgjegjëse me gjymtyrë të dytë gjithmonë -*bërës* e -*punues*, sepse semantikisht është përgjithësuar veprimi mbi sendin që prodhohet, p.sh. *opingar-opingabërës*, *djathtar-djathbërës* (ose *djathpunues*).

Nga ana strukturore emërtimet e njerëzve sipas profesionit paraqiten në këto tipe:

a) emërtime njëgjymtyrëshe: *bukator*, *gjellëtor*, *opingar*, *lulishtar*, *vinçier* etj.

b) emërtime të përbëra, prej dy dhe rrallë prej tre emrave, si: *tornitor-axhustator*, *tornitor-frezator*, *mekanik-gjenerik*, *zdruckthtar-dogramaxhi*, *frezo-mekanik*, *karpentier-murator* etj.

c) emërtime perifrastike, ku emërtimi bëhet me një fjalë, kurse me fjalë të tjera tregohet lloji i punës, si: *maqinist i sharrave*, *prerëse*, *maqinist shtypshkronjash*, *pompist i pusit*, *pompist i solucionit*, *pompist i brendshëm*, *shitës cigaresh*, *shitës biletash*, *paketues cigaresh*, *paketues i ushqimeve të gatshme* etj. . . Ky grup përdoret vetëm në emërtimet zyrtare, kurse në përdorimin e përditshëm të popullit njerëzit sipas profesionit përkatës emërtohen vetëm me gjymtyrën e parë.

Në planin fjalëformues veçoria themelore e zhvillimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit pas çlirimit është prodhimitaria e madhe e emërtimeve, duke shfrytëzuar mjetet fjalëformuese të shqipes. I) Sipas tipit të fjalëformimit prapashtesore janë formuar më dendur emërtime me prapashtesat: 1) -*es*, -*ës*, -*tar*, *tor*, -*ar*.

Katër prapashtesat e para janë bërë shumë prodhuese në gjuhën shqipe. Gjallërimi i tyre është i lidhur ngushtë me specializimin e prodhimit, me ndarjen profesionale të saj dhe i përgjigjet natyrës së shqipes. Prapashtesa -*ar* mjaft e përhapur edhe në periudhën e paraçlirimit, sot mund të përdoret më dendur për të formuar emërtime njerëzish sipas profesionit. Me këto prapashtesa formohen emërtime nga tema foljore (*shkrirës*, *petëzues*, *fërkues*, *fryrës*, *asfaltues*, *korrektues*, *montues*, *ndërtues*, *prerës*, *hërrtar*, *mihhtar*, *prestar*, *qëndistar* etj.) dhe nga tema emërore (*gjuhëtar*, *naftëtar*, *lulishtar*, *bletar*, *vreshtar*, *gazetar*, *kafshar*, *pendar*, *opingar*, *peshkatar*, *bukatar*, *arkëtar*, *zjarrmëtar*, *mishtar*, *lëkurtar*, *gjqytar*, *furrtar*, *farkëtar*, *armëtar*, *këngëtar*, *punëtor*, *barrëtor* (hamall), *murator*, *gjellëtar* etj.). Në një grup më vete do të vendosim emërtimet që kanë hyrë drejtpërdrejt nga gjuhët latine dhe neolatine me -*ist*, e cila më vonë është ndjerë si prapashtesë në shqipe (*elektriciist*, *normist*, *pianist*, *buldozerist* etj.). Ky grup përdoret përgjithësisht, kur këto janë fjalë-terma ndërkombëtare, në raste të tjera ato duhen shqipëruar, në përshtatje me natyrën e fjalëformimit të gjuhës sonë.

3) Prapashtesa *-e* që sot është bërë mjaft prodhuese formon emërtimet e grave sipas profesionit nga emërtimet e profesionit të burrave (*pompiste, inxhinier, elektriciiste, motoriste, zhenerike, eskavatoriste, operatore, kallafatore, kombajnere, hekurkthyes, vinqiere* etj.). Mendojmë se kjo prapashtesë ka prirje deridiku të zëvendësojë prapashtesën *-eshë*. Sot gjejmë *profesore* për *profesoreshë, drejtore* për *drejtoreshë*.

4) Prapashtesa turke *-xhi* (*-çi*) e përdorur dendur në periudhën e paraclirimit jo vetëm në fjalë turke (*sahatçi, kafexhi, arabaxhi, bakërçhi, duhançhi, hançhi, kallajçhi, teneqexhi, qeramixhi, bostançhi, sazexhi* etj.), por edhe në fjalë shqipe (*furrçhi, sharrëçhi, baltaxhi, hekurçhi, kosaxhi, lëkurçhi, shollçhi* etj.) sot e ka humbur prodhimtarinë e saj dhe dita-ditës po zëvendësohet me prapashtesat e shqipes *-ar, -tar, -tor*.

Nga ana tjetër, duhet shënuar, se një pjesë e madhe e fjalëve me prapashtesën *-xhi*, si edhe e turqizmeve të tjera, që mund të takohen akoma sot në gjuhën tonë, e kanë humbur karakterin neutral dhe kanë fituar nuancë stilistike ironike, tallëse ose përbuzëse.

II. Emërtimet e formuara me anë të kompozimit kanë interes gjuhësor, prirje të qarta zhvillimi dhe zëvendësojnë fjalët e parme dhe formimet ekzistuese prapashtesore. Te këto emërtime vihet re prirja e sotme e shqipes për të zbrëthyer në mënyrë të tejdukshme nocionin «Në thelb këtu pasqyrohet jo vetëm ndikimi i produktivitetit të kompozimit, por edhe stimuli i vetë kompozimit»¹⁵ a) Këto kompozita kanë si komponent të parë temën emërore që tregon produktin dhe sendin e punës dhe si komponent të dytë një emër foljor të vepruesit (nomen agentis), si: *-punues, -bërës, -ndreqës, -shitës, shtrues, -rojtës, -ndezës, -regjës, -rritës, -gdhendës, -skalitës, -shënues, -shpërndarës, -fshirës, -kthyes, -pjekës* etj. (*lëkurpunues, leshpunues, hekurpunues, teneqepunues, samarpunues, karropunues, qerrepunues, jorganpunues, bravapunues, gjellëbërës, opingabërës, këpucëbërës, librashitës, gazetashitës, pijeshitës, pullashitës, cigareshitës, duhanshitës, pemëshitës, pllakashtrues, shinashtrues, fillrojtës, pularuajtës, minandezës, lëkureregjës, bletërritës, gurgdhendës, gurskalitës, kohëshënues, letërshpërndarës, oxhakfshirës, hekurkthyes, bukëpjekës* etj.).

b) Kompozita të formuara nga dy a më shumë emëra (*kryesekretar, kryeinxhinier, kryellogaritar, kryesondist, kryeveteriner, kryekonomist, kryeoperator, kryeregjizor, kryepjekës, kryebari, kryegjeolog, kryearkëtar, ndihmësmekanik, ndihmëstraktorist, ndihmëssaldator, ndihmësveteriner, ndihmësagronom, ndihmëselektriciist, ndihmëspompist, ndihmësmurator, ndihmësoperator* etj.).

c) tema *elektro*+emër (*elektroteknik, elektrovincier, elektrosaldator, elektrofiltërues, elektromontator* etj.)¹⁶

Vështrimi i disa çështjeve të zhvillimit të kategorisë së emërtimeve të njerëzve sipas profesionit të çon në këto përfundime. Në njëzetepesë vjetët e çlirimit ka pasur një plotësim të pandërprerë dhe intensiv të kategorisë së emërtimeve të njerëzve sipas profesionit, si rezultat i ndryshimeve të thella politike, ekonomike dhe shoqërore. Zgjerimi i kategorisë së emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në këtë periudhë, kaloi në

15) A. Kostallari, *Mbi tiparet kryesore të shqipes së sotme letrare*, «Shkencat shoqërore në shkollë», Nr. 2, 1967, f. 70.

16) Këtu nuk po përmendim dhe një sërë kompozitash të huajtura nga gjuhët e huaja, si: *kartograf, topograf, skicograf, rentgenolog, dermatolog, patolog* etj. sepse nuk kanë interes për problemin që po shqyrtojmë.

rrugën e rritjes sasiore dhe lëvizjeve cilësore të saj. Në këtë periudhë u shfaqën ndryshime thelbësore në karakterin e motivimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit: rindarja sipas tipeve bazë kuptimore tregoi mbizotërimin e emërtimeve sipas procesit të punës, në ato degë të ekonomisë, ku ka kualifikim, specializim, ku ka prirje të mëtejshme zhvillimi¹⁷. Gjithashtu u zgjerua grupi i emërtimeve sipas mjetit të punës, përballë zvogëlimit të pjesës së emërtimeve sipas produktit të punës, që mbizotëronte në periudhën e mëparshme.

Në planin fjalëformues veçoria themelore e zhvillimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit është prodhimitaria e madhe e tyre sipas tipit të fjalëformimit prapashtesor me prapashtesat shqipe *-es, -ës, -e, -tar, -tor* dhe me anë të kompozimit. Në këtë drejtim fjalorët e gjuhës së sotme shqipe, qoftë shpjegues, qoftë dygjuhësh, në përshtatje me ndryshimet politike, ekonomike dhe shoqërore duhet të pasqyrojnë në mënyrë sa më të plotë emërtimet e njerëzve sipas profesionit. Drejt duhet të pasqyrohet dhe gjallërimi i mjeteve fjalëformuese të shqipes, veçanërisht i prapashtesave *-es, -e, -tar* dhe i kompozimit, rrëgjimi i disa prapashtesave si *-xhi*, duke pasur parasysh vlerësimin stilistik të saj. Në këta fjalorë, mendojmë, se nuk duhet të kenë vend emërtimet që janë terma tepër speciale në një fushë të caktuar terminologjike.

Hartimi i «Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe», i cili do të përfshijë «gjerësisht emërtime profesionale që shënojnë personat simbas veprimtarisë që tregojnë në këtë ose atë degë të prodhimit shoqëror, të shkencës, të teknikës, të arteve, të administratës shtetërore, të institucioneve kulture» etj.¹⁸, nxjerr para studjuesve tanë probleme që duan zgjidhje. Me punimin tonë prekëm disa çështje mbi prirjen e zhvillimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit, por mbeten për t'u studjuar një sërë çështjesh të tjera. Problemi kuptimor (semantik) dhe fjalëformues, që ne vetëm sa e cekëm, mund të bëhet objekt i studimeve të veçanta, veçanërisht prirja e sotme e shqipes për të emërtuar njerëzit sipas procesit të punës.

Studime të veçanta mund të bëhen për emërtimet e njerëzve sipas profesionit në degë të veçanta të ekonomisë, si në industri, tregëti, artizanat, bujqësi, ose, ndofta, edhe më të specializuara për degët e ekonomisë. Interes paraqet dhe problemi i sinonimisë dhe i polisemisë në emërtimet e njerëzve sipas profesionit. Studime të kësaj natyre, së bashku me hartimin e fjalorëve terminologjikë, janë të rëndësishëm dhe të nevojshëm, për më tepër, në kohën tonë kur këto emërtime po përdoren dendur jo vetëm në gazeta, revista ose literaturë speciale, por edhe në letërsinë artistike, ku përshkruhet jeta e njerëzve tanë të punës. Në këtë mënyrë do të ndihmohet në ngulitjen e përdorimit të tyre drejt.

LITERATURA

- 1) A. Abdihoxha, «Tri ngjyra të kohës», vol. III, Tiranë 1969.
- 2) A. Dushku «Rrethi i hekurt», Tiranë 1969.
- 3) A. Kondo, «Ura», Tiranë 1968.
- 4) A. Z. Çajupi «Vepra», Tiranë 1957.

17) E kemi fjalën për ato emërtime që sot janë ngulitur jo vetëm si emërtime zyrtare, por edhe në përdorimin e përditshëm.

18) A. Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe*, «Studime filologjike», 1968, nr. 2. f. 65.

- 5) B. Myftari, «Fluturzat e borës», Tiranë 1967.
- 6) «Drita», dhjetor 1968; mars, prill 1969,
- 7) Dh. S. Shuteriqi, «Këngë në minierë», Tiranë 1968.
- 8) «Fjalori i gjuhës shqipe», Tiranë 1954.
- 9) F. Cordignano, «Dizionario Albanese-Italiano», Milano 1934.
- 10) «Fletorja Zyrtare», mars 1923 — maj, dhjetor 1936; prill 1937.
- 11) «Gazeta Zyrtare», 1945, 1947, 1948, 1964, 1967.
- 12) G. Kongoli, «Mali», Tiranë 1967.
- 13) K. Kristoforidhi, «Fjalor shqip-greqisht», Pragë 1961.
- 14) K. Rafaili, «Njësitë gueril në veprim», Tiranë 1968.
- 15) K. Resuli, «Ushëtima e Korabit», Tiranë 1968.
- 16) «Në shërbim të popullit», Nr. 12, 1968.
- 17) «Përpara», mars, Korçë 1969.
- 18) «Puna», prill 1969.
- 19) «Sigurimet shoqërore shtetërore», Tiranë 1968.
- 20) «Sporti popullor», prill, korrik, shtator 1969.
- 21) «Shqiptarja e re», Nr. 3, 7, 1969.
- 22) «Udhëzime mbi detyrat e nëpunësve të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë», Tiranë 1969.
- 23) «Ylli», 1, 1966; 2, 3, 6, 7, 1969.
- 24) «Zëri i Popullit», korrik 1968; janar, shkurt, mars, prill, qershor, korrik 1969.

R é s u m é

OBSERVATIONS SUR LES DENOMINATIONS DES HOMMES D'APRES LA PROFESSION

L'auteur traite, dans son exposé, l'état des dénominations des hommes d'après la profession avant et après la libération, son reflet dans les principaux dictionnaires de la fin du XIX^e - commencement du XX^e siècles notamment dans la *Dictionnaire de l'albanais* de 1954. Il y est question également de l'influence des transformations sociales après la libération dans le domaine des dénominations des hommes selon la profession et des tendances actuelles de développement dans le domaine de la formation des mots.

Les dénominations des hommes d'après la profession se répartissent en types sémantiques d'après le processus, le moyen, le produit, la matière ou l'objet, la place de travail et d'après la branche de l'économie. De l'intérêt offre l'examen de la répartition en groupes au point de vue de l'abstraction sémantique de formation des mots, où le degré de cette abstraction n'est pas identique.

Sur le plan de la formation des mots, la particularité fondamentale du développement des dénominations des hommes d'après la profession après la libération est la grande productivité des dénominations selon le type de la formation préfixale ou suffixale des mots *-es*, *-ës*, *-tar*, *-tor* et au moyen de la composition. Par conséquent, l'étude de ce problème est importante au double point de vue linguistique et social, du fait que les dénominations des hommes selon la profession illustrent les transformations qui interviennent dans la vie sociale et sont en rapports étroits avec l'activité productive. Ces dénominations font état, souvent, des aspects différents de la production, qui reflètent à leur tour les modifications intervenues dans la division du travail, les procédés technologiques de la production, la spécialisation de ces procédés, les moyens, les objets, les produits du travail, les changements de propriété. etc.